



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2022:116528

Datë: 14.10.2024

Numri i dokumentit: 06295265

**C.nr.320/2022**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI**, gjyqtari Arben Xheladini, me bashkëpunëtorin profesional Fitim Limani, në çështjen kontestimore të paditësit N.M., nga fshati K., Komuna e I. të cilin me autorizim e përfaqëson avokati A.K.nga Peja, ndaj të paditurve G.M., L.M.nga fshati K., Komuna Viti, si dhe B.S., nga fshati S., Komuna Viti, të cilët i përfaqëson avokati Edis Kuraja nga Prishtina, me objekt të kontestit kompensim i dëmit, vlera e kontestit 50.000 €, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor më datë 27.09.2024, jashtë seancës mori këtë:

**AKTGJYKIM**

I. Miratohet pjesërisht e themeltë kërkesëpadia e paditësit, N.M., detyrohen të paditurit G.M., L.M. dhe B.S.që paditësit, për shkak të lëndimit të rëndë shkaktuar më datë 26.09.2021, në mënyrë solidare, t'ia shpërblejnë dëmin: për dhimbje fizike 4000 €, për frikë 4000 €, për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm aktivitetit jetësor në shkallë 5% shumën prej 3000€, për dhimbje shpirtërore për shkak të shëmtimit në shkallë të mesme 3000 €, për kujdes nga personi i tretë 6 javë shumën prej 500 € dhe për ushqim të përforcuar për 6 javë shumën prej 500 €, të gjitha në shumën prej 15000 €, me kamatë ligjore 8%, për dëmin jo material e llogaritur nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit, ndërsa, për dëmin material nga dita e dorëzimit të padisë në gjykatë, e deri në pagesën e plotë, në afat prej 15 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit.

II. Refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit kundër të paditurve G.M., L.M.dhe B.S., e kërkuar përtej shumës së miratuar në pikën I, për dhimbje 6000 €, për frikë 6000 €, për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor 2000 €, për dhimbje shpirtërore për shkak të shëmtimit trupor 2000 €, në emër të kujdesit nga personi i tretë 500 €, të gjitha në shumë prej 16500 €.

III. Refuzohet kërkesëpadia e paditësit, me të cilën ka kërkuar të detyrohen të paditurit, G.M. dhe L.M., në emër të borxhit, t'ia paguajnë shumën prej 6.500 € më kamatë ligjore 8 % e llogaritur nga muaji qershor 2021.

IV. Detyrohen të tre të paditurit që paditësit, në mënyrë solidare, t'ia paguajnë shpenzimet e procedurës në shumë prej 1897.60 €, në afat prej 15 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit.

**Arsyetim**

Paditësi N.M., më datë 07.06.2022, ka ngrehë padi kundër të paditurve, G.M., L.M.dhe B.S., me kërkesë që të paditurit, në mënyrë solidare, t'ia paguajnë dëmin material dhe jo material të shkaktuar me veprim të kundërligjshëm më datë 26.09.2021, për çka të paditurit, në procedurë penale ishin gjetur fajtorë, ndërsa, tani paditësi, si i dëmtuar në atë rast, për realizimin e kërkesës pasurore, ishte udhëzuar në kontest civil.

Këto pretendime, përfaqësuesi i paditësit i ka përsëritur gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, kurse me datën 27.09.2024, e ka bërë saktësimin e kërkesëpadisë dhe nga gjykata ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të miratohet e bazuar, të detyrohen të paditurit, që në mënyrë solidare, paditësit t'ia paguajnë dëmin material dhe jo material edhe atë: për të gjitha format e dhimbjeve shumë prej 10.000 €, për të gjitha format e frikës së përjetuar shumë prej 10.000 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shumë prej 5.000 €, në emër të shëmtimit trupor shumë prej 5.000 €, për kujdes nga personi i tretë për 6 javë shumë prej 1.000 €, për ushqim të përforcuar për 6 javë shumë prej 500 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë. Gjithashtu, në precizimin e kërkesëpadisë, kërkohet nga i padituri i parë dhe i dytë kompensimi në shumë prej 6.500 € në emër të borxhit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuar dhe atë: për përpilim të padisë 416 €, për përfaqësim në dy seanca secila nga 540.80 €, për dy ekspertiza mjekësore secila nga 150 €, për taksë për padi 100 €, të gjitha në shumë 1897.60 €, duke u bazuar në Rregulloren për Tarifa të OAK-së.

Përfaqësuesi i të paditurve në përgjigje në padi, shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se pretendimet e paditësit janë të paargumentuara dhe nuk janë mbështetur në prova por vetëm në supozime, kështu që ka theksuar se paditësi pa bazë ligjore dëshiron të fitoj kompensim të dëmit më të lartë. I ka kundërshtuar ekspertizat mjekësore, si atë të ortopedisë edhe të psikiatrisë me pretendimin se janë bazuar në perceptimin subjektiv dhe ankesat e paditësit, e jo në provat objektive dhe parime shkencore. Duke argumentuar kundërshtimet e tij, ka theksuar se paditësi me qëllim që të paraqitjes së gjendjes shëndetësore më të rëndë, kontrollat i ka bërë në ordianca private e jo të institucione shëndetësore publike, në mënyrë që, kundërligjshëm, të kërkoj kompensim më të madh të dëmit. Për këto arsye, ka kërkuar që gjykata ta refuzoj të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata e ka miratuar propozimin e paditësit për administrimin e këtyre provave materiale: raportin mjekësor me numër 19640, i datës 26.09.2021, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Gjilan, në emër të tani paditësit N.M., raportin mjekësor i lëshuar nga Ambulanca Specialistike Ortopedike-Traumatologjie "Ortopedia-J", i datës 01.10.2021 dhe 04.10.2021, raporti mjekësor nga "Kavaja Hospital", i datës 05.10.2021, raporti i rezonancës magnetike, i lëshuar nga ordianca radiologjike "Roentgeni", në emër të tani paditësit, aktgjykimi i kësaj gjykate me numër P.nr.442/2022, i datës 04.11.2021, i formës së prerë nga data 11.03.2022, si dhe ka siguruar provën me ekspertizën mjekësore të ortopedisë dhe psikiatrisë.

Nga qëndrimi i palëve gjatë shqyrtimit, nuk ka rezultuar kontestues fakti se të paditurit, me aktgjykimin penal P.nr. 442/2022, i formës së prerë nga data 11.03.2022, janë shpallë fajtor për veprën penale, lëndim i rëndë trupor, të kryer ndaj Nikollë Merditaj më datë 26.09.2021, dhe për këtë, secili ishte dënuar me dënim përkatës, ndërsa tani paditësi, për kërkesën pasurore juridike ishte udhëzuar në proces kontestimor.

Edhe pse tani të paditurit, e kishin pranuar fajësinë për veprën penale lëndim i rëndë trupor, e kontestonin natyrën e lëndimit të pësuar nga paditësi më datë 26.09.2021. Për këtë arsye, çështjet kontestuese lidhur me natyrën e lëndimit, gjykata i zgjidhi përmes ekspertizës nga lëmia e ortopedisë, ndërsa çështjet që ndërlidheshin me frikën e përjetuar dhe pasojat, e zgjidhi përmes ekspertizës së psikiatrisë.

Pas administrimit të ekspertizës së ekspertit ortoped dhe të ekspertit të psikiatrisë, përfaqësuesit e palëve, hoqën dorë nga administrimi i provave materiale-raporteve mjekësore.

Me administrimin e ekspertizës së hartuar nga Dr. Musa Jashari, ekspert ortoped i licencuar, gjykata ka vërtetuar se të paditurit, me veprime të kundërligjshme të ndërmarra më datë 26.09.2021, paditësit i kanë shkaktuar lëndime të shumëfishta – nga të cilat, lëndimi i gjurit ka rezultuar të jetë i natyrës së rëndë. Se për shkak të lëndimit, paditësi ka përjetuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të lartë 30 minuta – dhe kjo ka zgjatur deri në momentin kur paditësit i është dhënë terapia e parë pas lëndimit; dhimbje fizike të lartë 3 ditë – pas marrjes së terapisë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm 10 ditë, dhimbje me intestitet të ulët ende prezente sidomos gjatë ecjes. Gjithashtu, eksperti ka vërtetuar se për shkak të lëndimit, paditësi ka pësuar zvogëlim të përgjithshëm të aktivitetit jetësor në shkallë 5%, shëmtim në shkallë të mesme në regjionin temporal të kokës me dimensione 6 cmm x 0.5 cm shëmtim që shihet edhe nga të tjerët, dhe në regjionin e gjurit 2 cm x 0.5 cm, ka pasur nevojë për përkujdesje nga personi i tretë për 6 javë, për ushqim të përforcuar për 6 javë.

Me administrimin e eksperizës së hartuar nga Dr. Shkelzen Kadriu, ekspert psikiatër i licencuar gjykata ka vërtetuar se paditësi në ditën kritike ka pësuar frikë primare që ka zgjatur disa minuta, frikë sekondare e cila ka vazhduar deri kur është dërguar për marrjen e ndihmës së parë në emergjencën e Spitalit Regjional të Gjilanit, frikë të intensitetit të lartë e cila ka zgjatur 7 ditë, frikë të intensitetit të mesëm e cila ka zgjatur 2 muaj, si dhe frikë të intensitetit të lehtë e cila ka zgjatur 1 muaj.

Pasi gjykata i ka administruar provat materiale, në bazë të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), i ka çmuar një nga një dhe të gjitha së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj, edhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga çmuarja provave materiale, gjykata, kërkesëpadinë e paditësit e miratoi pjesërisht si në pikën I të dispozitivit, pasi me aktgjykimin P.nr.442/2022, i datës 04.11.2021, i formës së prerë nga data 11.03.2022, ka vërtetuar bazën ligjore të kërkesëpadisë së paditësit, e që sipas nenit 14 të LPK-së “Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.”

Ekspertizës së ekspertit ortoped, gjykata ia falë plotësisht besimin pasi ishte profesionale, me të cilën janë vërtetuar faktet kryesore të çështjes për kërkesat e paditësit. Eksperti, edhe në seancën e shqyrtimit kryesor, ka dhënë sqarime lidhur me të gjitha çështjet e përfaqësuesit të të paditurit. Eksperti ka arsyetuar se për shkak të goditjeve, paditësi ka pësuar lëndime të shumëfishta edhe atë: rupturë/shqyerje e meniskut medial majtas në gjurin e majtë, e që sipas tabelave orientuese mjekësore të Ministrisë së Shëndetësisë, Tabela III, pika 2.3.5 a) është lëndim i rëndë trupor. Ndërsa, lëndime tjera plagë shqyse/çarëse në regjionin parietal kalvari i kokës ana e majtë, gërvishtje të lëkurës në regjionin tëmthit ballor majtas dhe këndit të nofullës së poshtme djathtas e shoqëruar me një hematomë, gërvishtje e lëkurës në regjionin e gjurit janë lëndime të lehta, megjithatë, ka shtuar se të gjitha këto lëndime, janë të mjaftueshme për të shkaktuar dhimbje fizike me intensitet posaçërisht të lartë, të cilat paditësi i ka përjetuar për 30 minuta, e që ky intensitet ka filluar të bie nga momenti kur i është dhënë terapia e parë kundër dhimbjeve. Ka shtuar se me aplikimin e terapisë kundër dhimbjeve, dhimbjet nga intensiteti posaçërisht i lartë kalojnë në intensitet të lartë e që kanë zgjatur tri (3) ditë, për të vazhduar pastaj me intensitet të mesëm 10 ditë, ndërsa me intensitet të ulët janë prezentë edhe tani, më të theksuara gjatë ecjes. Eksperti ka dhënë sqarime edhe lidhur me konstatimin se paditësi ka pësuar zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 5 %, me arsyetimin se te lëndimet e meniskut sidomos atij medial/të brendshëm, i cili zë një sipërfaqe prej 70 % të gjurit, zakonisht i pari lëndohet në kuptim të çarjes/rupturës që përveç dhimbjeve, shkakton edhe pasiguri në ecje dhe jo qëndrueshmëri të

gjurit (gjuri nuk ka stabilitet), dhe në shumicën e rasteve kërkohet intervenim kirurgjik për të hequr pjesën e shqyer ose qepjes së saj, intervenimi i tillë nuk është urgjent. Se në ditën e ekzaminimit fizik të paditësit, në kërkesën e ekspertit për të ecur në maje të gishtave dhe thembrave, paditësi nuk ka pasur qëndrim normal.

Ekspertizës së ekspertit psikiatër, gjykata ia fali plotësisht besimin pasi ishte profesionale, me të cilën janë vërtetuar faktet kryesore të çështjes për kërkesat e paditësit. Eksperti, edhe në seancën e shqyrtimit kryesor, ka dhënë sqarime lidhur me të gjitha çështjet e përfaqësuesit të të paditurit. Eksperti ka sqaruar se frika primare ka zgjatur aq sa ka zgjatur edhe konflikti fizik ndërmjet palëve të përfshira, e që në këtë rast, kanë qenë tre persona ( të paditurit) kundër një personi (paditësit), duke shtuar se frika primare nuk mund të përcaktohet saktë me minuta, e për këtë arsye në ekspertizë e ka shënuar se ka zgjatur disa minuta. Se konstatimin e frikës sekondare e ka bazuar në bazë të intensitetit të lëndimeve dhe trajtimit, se frika sekondare është pasojë e lëndimeve të marra dhe frikës për pasojat nga këto lëndime, andaj edhe konstatimi i frikës sekondare me intensitet të lartë prej 7 ditëve bazohet se gjatë kësaj periudhe tani paditësi ka marrë trajtim intensiv për plagët e shkaktuara, e cila pastaj është shfaqur me intensitet të mesëm dhe të ulët në kohëzgjatje si në konstatimin me shkrim. Eksperti ka dhënë sqarime edhe lidhur me konstatimin e “frikës së mëvonshme” si në procesverbalin e datës 27.09.2024.

### Baza ligjore

Si ligj material e zbatohet Ligjin e Marrëdhënieve të Detyrimeve të vitit 2012, të cilit tani e tuje do t'i referohet me shkurtesën LMD, konkretisht: Nenin 137: “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material”); Neni 169: “Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. 2. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla. 3. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit.”; Nenin 183.1 “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. 183.2: “Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.”

Pasi gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike si më lart, ka vlerësuar se dhimbjet e përjetuara fizike, intensiteti dhe kohëzgjatja e arsyetojnë gjykimin e dëmshpërblimit në të holla në shumë prej 4000€, pasi paditësi ka pësuar lëndime të shumëfishta, për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 3000 € pasi për shkak të lëndimeve, paditësi ende i vuan pasojat kryesisht gjatë ecjes, meqë i është shqyer menisku i gjurit. Për shëmtim shumën 3000 € - shëmtimi është i shkallës së mesme në regjionin temporal të kokës me dimensione 6 cm x 0.5 cm dhe ky shëmtim shihet edhe nga të tjerët, dhe në regjionin e gjurit 2 cm x 0.5 cm që mund të shihet vetëm në rastet kur paditësi vishet me rroba të shkurtra - pantallona të shkurtra.

Kërkesën e paditësit për frikën e përjetuar, gjykata e miratoi në shumën e kërkuar 4000 € pasi me ekspertizë të ekspertit psikiatër u vërtetua se paditësi ka pësuar frikë primare e po ashtu edhe frikë sekondare, e cila është përshkallëzuar në kohëzgjatje si në mendimin me shkrim të ekspertit.

Gjykata vlerëson se shumata e gjykuara, janë adekuate në raport rëndësinë e shkeljes së të mirës së mbrojtur, dëmet e pësuar, e gjithashtu edhe me kriteret dhe qëllimin shpërblimit, për të arritur sadopak një satisfakcion, edhe pse në parim, këto forma të dëmit vështirë se mund të kompensohen me para. Po ashtu, është vlerësuar se miratimi i këtyre shumave nuk përbën ndonjë përfitim që është në kundërshtim me qëllimin e shpërblimit të dëmit ashtu siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 183 të LMD-së.

Gjykata e ka miratuar pjesërisht kërkesën e paditësit për ndihmë të personit të tretë, pasi ka vërtetuar se paditësi ka pasur nevojë për ndihmë nga pesoni i tretë, e që zakonisht kjo formë e dëmit jepet në shtëpi nga anëtarët e familjes. Lidhur me lartësinë e gjykuar, gjykata u bazua në praktikën gjyqësore, ashtu që për këtë formë të dëmit e miratoi shumën prej 500 €. Edhe kërkesa për ushqim të përforcuar u aprovua duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit ortoped, pasi në rastet e dëmtimit të shëndetit, personi ka nevojë për ushqim të përforcuar me vitamina dhe minerale të ndryshme, ndërsa, lartësia e gjyluar në shumë prej 500 € u bazua në kohëzgjatjen e kësaj nevojë dhe kriteret sipas praktikës gjyqësore në këto raste.

Gjykata i ka refuzuar kërkesat si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, për të gjitha format e dhimbjeve shumën prej 6000 €, për të gjitha format e frikës së përjetuar shumën prej 6000 €, për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shumën prej 2000 €, për dhimbje shpirtërore për shkak të shëmtimit trupor shumën prej 2000 €, në emër të kujdesit nga personi i tretë për 6 javë shumën prej 500 €, të gjitha në shumë prej 1500 €, pasi ka vlerësuar se shumata e kërkuara me tepër se ato të gjykuara për këto forma të dëmit, janë të larta dhe nuk do t'i shërbenin qëllimit të shpërblimit të dëmit.

Gjykata e refuzoi kërkesën e paditësit si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, e kërkuar në emër të borxhit në shumë prej 6.500 €, ngase paditësi me asnjë provë nuk e ka mbështetur kërkesën, përkundër që ka pasur barrën e provës sipas nenit 7.1 të LPK-së.

Lidhur me kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së, ashtu që i detyroi të paditurit që paditësit, t'ia paguajnë shumata si në pikën I të dispozitivit me kamatë ligjore 8% në vit, për dëmin jo material e llogaritur nga data e nxjerrjes së aktgjykimit, ndërsa, për dëmin material nga dita e dorëzimit të padisë në gjykatë.

Gjykata e ka refuzuar kërkesën e përfaqësuesit të paditësit për sigurimin e dosjes penale P.nr.442/2022 pasi nuk e ka vërtetuar pretendimin se dosjen e ka kërkuar nga arkiva e gjykatës ndërsa kërkesa i është refuzuar apo në ndonjë mënyrë tjetër i është pamundësuar sigurimi i shkresave.

Gjykata e ka refuzuar propozimin e përfaqësuesve të të paditurve për ekspertizë të dytë nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë sepse, ekspertizat e ekspertëve janë vlerësuar profesionale, të dy ekspertët kanë dhënë sqarime të detajuara dhe bindëse për të gjitha çështjet që i ngrehi përfaqësuesi i të paditurve. Konstatimit të ekspertit ortoped jo që gjykata nuk ia fali besimin, por paditësi nuk ka kërkuar shpërblim të dëmit për kategori të dëmit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452, 453 dhe 463 të LPK-së, shpenzimet e kërkuara kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjykatë dhe u kërkuar të specifikuar. Për këtë arsye, të paditurit u detyruan që paditësit, në mënyrë solidare, t'ia

paguajnë këto shpenzime të procedurës: për përpilim të padisë 416 €, për përfaqësim në dy seanca secila nga 540.80 €, për dy ekspertiza mjekësore secila nga 150 €, për taksë për padi 100 €, të gjitha në shumë 1897.60 €, duke u bazuar në Rregulloren për Tarifa të OAK-së. Fakti se kërkesat e paditësit nuk u miratuan sipas lartësisë së kërkuar, është i pandikim në lartësinë e shpenzimeve të miratuara pasi paditësi pati sukses në vëretetimin e bazës ligjore të të gjitha kërkesave të miratuara në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit. As refuzimi i kërkesës së paditësit si në pikën III të dispozitivit, nuk ka qenë me ndikim në lartësinë e shpenzimeve të miratuara, pasi paraqitja e kësaj kërkesë nuk ka ndikuar në shtyrjen dhe/ose zvarritjen e shqyrtimit gjyqësor apo shkaktimin e ndonjë shpenzimi për të paditurit.

Nga të lartcekurat e duke u bazuar edhe në nenin 142 dhe nenin 7.1 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI**  
**C.nr.320/2022, datë 27.09.2024**

**Gjyqtari,**

Arben Xheladini

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet përmes kësaj gjykate.